



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik  
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-13176/20

Kaçanik, 30.06.2020

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IV (Katërt)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2020 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 30 Qershor 2020. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve të KK, pjesëmarrës në mbledhje janë 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj pa arsye anëtarja, Afërdita Shehi.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, 07 drejtorët e drejtorive komunale: ndërkaq nga zyrtarët e komunës: Ilir Lumi, Bejtulla Dalloshi, Ilirijana Berisha dhe Arbnora Kuka.

Nga KDI, mbledhja u monitorua nga Kijani Sallahu.

Nga niveli qendror, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Për shkak të pandemisë Covid-19, në sallën e KK janë krijuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes me distancë fizike, pajisje më maska mbrojtëse dhe dezinfektues.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli,** Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, kuorumi me u mbajtur mbledhja ekziston, prezent në mbledhje konstatohet së janë 26 anëtarë, mungon pa arsye, Afërdita Shehi. Pasi jemi prapa me mbledhje të KK për shkak të pandemisë Covid -19, ka mundësi që në muajin Korrik t'i mbajmë 2 mbledhje të KPF dhe 2 mbledhje të KK. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ekziston, andaj e hapi mbledhjen e IV (Katërt) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2020, data 30 Qershor, me këtë:

## REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Draft propozimi final për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008;
3. Harmonizimi i Rregullores 01Nr. 02-60/01-4863/20 e datës 28.02.2020 -për Taksat Komunale, në bazë të komenteve të MPB;
4. Draft- Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut për vitet 2021-2023;

5. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për N.K.P “Stacioni i Autobusëve” SH.A. - Kaçanik;
6. Propozim Vendim për rialokim dhe transfer të mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020;
7. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën private të Mustafë Lama, për ndërtimin e rrugës në Kaçanik të Vjetër; dhe
8. Raporti i Shtabit Emergjent për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

#### APROVOJ

#### **Rendin e Punës në përbërje prej 8 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK e keni marrë, nëse ka kush diçka lë të urdhëroj; Atëherë meqë nuk ka kush vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes së III të Kuvendit të komunës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

#### APROVOJ

**Procesverbalin nga mbledhja e III-të (Tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2020 të datës 27 Maj 2020 / Lënda: 01Nr. 60/01-9898/20.**

#### **Pyetjet dhe Kërkesat**

**z. Ekrem Kyçyku**, Edhe në mbledhjen e kaluar e kam potencuar edhe sot po e potencoj së nuk kam marrë përgjigje në dy kërkesa të cilat i kam ngritur në mbledhjet e KK.

1. Në emër të qytetarëve të Komunës së Kaçanikut kam një Kërkesë për sqarime të nevojshme së çka po ndodhë me Qarshinë e qytetit.
2. Kam dëgjuar së po jepen leje për ndërtimin e vilave në zonën turistike në f. Shtrazë. Kërkoj të na e sqaroni se si është procedura, a duhet të merret Pëlqimi nga Komuna për ndërtimin e vilave në atë zonë turistike.

**z. Adnan Reka**, Kërkojmë që të rregullohet ndriçimi publik njëherë e mirë, nga shtëpia e kulturës “Xheladin Kurtaj” deri tek xhamia e dëshmorëve, sepse siç kemi thënë edhe më parë, mënyra siç Ju po e neglizhoni në vazhdimësi, me vetëdije apo pa vetëdije, po i kontribuoni rritjes së aktiviteteve të ndaluara që ndodhin në këtë pjesë të qytetit.

**znj. Lirije Shurdhani**, Unë kam një kërkesë për drejtorin e shërbimeve Publike; Rruga “Muhamet Zeneli” në f. Bob ka pasur disa probleme, ndërkaq keni thënë që është në provë për tu rregulluar për arsye të nxehjes së gypave gjatë reshjeve të vullshme. A keni marrë ndonjë vendim për rregullimin e asaj rruge.

**znj. Kaltrina Tafili**, Unë e kam një Kërkesë për Drejtorinë e Infrastrukturës lidhur me rrugët të cilat janë filluar me u ndërtuar dhe janë lënë në gjysmë. Disa rrugë janë dëmtuar, si rrugët: në ‘Lagjja e Re’ dhe rruga në lagjen: “Dushkaja”. Rruga në “Lagjja e Re” ka kohë që është dëmtuar, ndërkaq nuk është marrë ndonjë veprim për rehabilitimin e saj. Në rrugën në lagjen

“Dushkaja” pothuajse në çdo hap ka prerje të asfaltit, ndërkaq nuk është marrë asnjë hap për rehabilitimin e saj. Më intereson kur do të rehabilitohen këto rrugë, ndërkaq ka edhe rrugë të tjera të cilat janë dëmtuar me prerje asfalti dhe krijimin e gropave, të cilat rrugë kanë nevojë për rehabilitim.

**z. Bekim Koxha,** Rruga prej Shkëndija Petrol deri në f. Rakaj- rruga e vjetër është bërë shumë më mbeturina. Pse nuk merret ndonjë veprim për pastrimin e asaj rruge. Më intereson të di, a është caktuar ndonjë lokacion për deponimin e materialeve të ngurta.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Lidhur me Kërkesat e ngritura, besoj se drejtorët e drejtorive kanë marrë shënime lidhur me kërkesat e ngritura dhe do të japin përgjigjet me shkrim ashtu siç jemi kuptuar. Atëherë kalojmë në pikët e tjera sipas radhës:

2. Draft propozimi final për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Iniciativë për me ndryshuar statutin e komunës kemi pasur edhe më herët si nevojë e harmonizimit të tij me me ligjet dhe aktet tjera në fuqi, pasi që Statuti i Komunës nuk është ndryshuar asnjëherë nga viti 2008 kur është aprovuar. Ne e kemi formuar komisionin për hartimin e statutit të komunës, komisioni ka dhënë draftin i cili është shqyrtuar në KPF, ndërkaq në KK drafti është shtyrë për shkak se nuk ka qenë pajtimi i subjekteve politike, pasi që statuti miratohet me 2/3 e votave të anëtarëve të përgjithshëm të KK. Fillimisht kërkoj që secili subjekt politik të jep komentet në këtë draft statut, duke u nisur nga subjektet politike me të mëdha, pastaj e hapim debatin:

**z. Nexhat Loku,** Në emër të subjektit politik të PDK konfirmoj së do të votojmë këtë draft statut.

**z. Ekrem Kyçyku,** Vërejtjet e LVV janë së, Ky draft statut vjen pas 2 viteve në shqyrtim në kuvend, me çka kujtoj së drafti në fjalë bien ndeshë me Udhëzimin Administrativ për transparencë në komuna 01/2015, sepse në UA shënohet që aktet e komunës i nënshtrohen procedurës së debatit publik me qytetarë, përfshirë edhe debatet në zona rurale. Gjithashtu draft statuti është në kundërshtim edhe me Rregulloren 01.2017 të MAPL për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve në komuna, për arsye se Zyra për integritet Evropiane duhet të bëjë harmonizimin e akteve të komunës me rregullat e Bashkësisë Evropiane, kjo nuk është bërë. Gjithashtu nuk kemi dokument nga Zyra për barazi gjinore së a është në harmoni ky akt me dispozitat e akteve që rregullojnë barazinë gjinore si dhe konfirmimin nga Zyra ligjore lidhur me ligjshmërinë e aktit. Draft statutit duhet t'i bashkëngjitet edhe konfirmimin për çështjen e implikimeve buxhetore, i cili konfirmim ka qenë me draftin në draftin fillestar. Duke u nisur nga këto, konfirmoj se LVV nuk do të votoj këtë draft statut.

**z. Selim Reka,** Ne LDK-a jemi kundër shtimit të numrit të drejtorive komunale, mirëpo për shkak të rëndësisë që ka Statuti i Komunës, nevojës me u harmonizuar me LVL dhe aktet tjera nënligjore në fuqi, atëherë ne LDK-a këtë herë do të arrijmë një kompromis që me miratuar këtë draft, me kusht që të shtimi i drejtorive komunale- neni 27 zbatimi i këtij neni të fillon në legjislaturën vijuese të organeve të komunës.

**z. Bekim Koxha,** Ndryshim plotësimet e propozuara në Statutin e Komunës, përfshirë edhe shtimin e drejtorive komunale neni 27, nëse Kryetari i Komunës e parasheh janë në interes

të qytetarëve të komunës dhe në interes të komunës, ne subjekt politik NIISMA do t'i mbështetim.

**z. Shemsedin Luzha**, Në emër të grupit parlamentar të Pavarur, konfirmoj së i mbështetim ndryshim plotësimet e propozuara në statutin e komunës ashtu si janë dhe do të votojmë Për.

**z. Ekrem Raka**, Unë edhe para dy viteve kur është propozuar me u ndryshuar dhe plotësuar Statuti i Komunës, kam thënë së jam për ndryshime plotësimin e statutit të komunës pa shtimin e drejtorive komunale, me çka edhe sot e kam të njëjtin mendim. Nëse hiqet neni 27 që ka të bëjë me shtimin e numrit të drejtorive komunale, unë do të votoj Për, sepse shtimi i numrit të drejtorive komunale, po bëhet me tepër për të rehatuar njerëz të pushtetit dhe familjarë, sesa që është nevojë e interes i komunës, ndërkaq në të kundërtën mendimi im është i qartë, do të votoj kundër. Rritja e numrit të drejtorive, nuk do të thotë së e rritë cilësinë e administratës. Nëse e marrim shembull një shtet shumë të zhvilluar me një funksion të mirë që shquhet për cilësi dhe efikasitet të administratës, shtetin e Zvicrës, Zvicra me 7 milion banorë funksionon me 7 ministri.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Lidhur me këtë pikë e hapi debatin:

**z. Festim Neziraj –drejtor i DAP dhe Kryesues i komisionit**, E ndiej obligim me bërë sqarime për çështjet të cilat u ngritën. Drafti Statuti i Komunës është proceduar në KK për shqyrtim në vitin 2018 dhe është tërhequr, për shkak së nuk ka pasur vullnet politik për miratim. Tani që e kemi proceduar këtë draft, ligjshmëria nuk ka ndryshuar, kërkesat e drejtorive janë të njëjta, kostoja financiare është e njëjtë, jemi duke bërë fjalë për draftin e njëjtë. Në konsultim me zyrën ligjore kemi konstatuar se jemi në rregull sa i përket ligjshmërisë së draftit. Se a është akti në rregull apo jo, këtë e konstaton dhe e vërteton MAPL. Ne po besojmë se është në rregull me aktet të cilat u përmenden, drafti kur është hartuar i ka pasur konfirmimet e të gjitha njësive që u përmenden dhe ato dokumente ekzistojnë. Nga ana procedurale jemi krejt në rregull. Debatet publike me qytetarë janë mbajtur, nuk e di nëse keni marrë pjesë të gjithë anëtarët e KK, ekzistojnë procesverbalet e mbledhjeve dhe besoj se jemi në rregull. Të çështja që e përmendi LDK, tani më e miratuar një akt dhe me hyrë në fuqi në vitin 2022 kjo është absurde dhe e pakuptimtë. Nëse jeni të pajtimit që drafti me u votuar ashtu si është propozuar me kusht që Kryetari i Komunës mos me emëruar drejtorët e atyre drejtorive komunale që shtohen, deri në legjislaturën vijuese, atëherë është në rregull.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Unë nuk jam jurist, por po besoj së procedura nuk lejon që një akt me u miratuar sot, ndërkaq disa dispozita me hyrë në fuqi më vonë pas 1 apo 2 viteve, sepse akti si i tillë nuk mundet me u ndarë. Besoj se si KK nuk e kemi ne atë të drejtë. Aktet e KK hynë në fuqi 15 ditë pas shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi**, I falënderoj të gjithë anëtarët e KK të cilët po mundohen me na ndihmuar në këtë drejtim. Ne kemi menduar se komisioni ka pasur qëndrim unik në propozimet e tyre dhe ka me dal unik në KK. Në këtë Draft Statut të jeni të bindur së nuk është duke u bërë politikë, por po e ndryshojmë statutin në mënyrë që të jetë i gatshëm për ata që vijnë në pushtet në legjislaturën vijuese të komunës për me funksionuar me këtë statut. Ka komuna të vogla si, Hanin e Elezit që funksionon me 8 drejtori, dhe shtimi i drejtorive nuk po bëhet me rehatuar partiak dhe familjarë. Unë kam thënë se kushdo mund të merr këto drejtori vetëm e vetëm për një funksionim të mirë të komunës e në veçanti ndarjen e Kulturës nga drejtoria e Arsimit, sepse kërkesat e qytetarëve kanë qenë për një funksionim më të mirë dhe është nevojë me u ndarë kjo drejtori, sepse aktivitetet kulturore kanë ardhur duke u shtuar dita

ditës. Insistimet e tilla të disa subjekteve politike të përfaqësuara në KK që thonë së është duke u bërë politikë me këto ndryshime të statutit, janë një praktikë jo e mirë. Ne kemi nevojë çdo herë për bashkëpunimin më të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në KK. Kjo iniciativë për ndryshime statusore ka qenë para 4 viteve, mirëpo kur kemi ardhur në fund të mandatit, është thënë mos po na hakmerren qytetarët në zgjedhje dhe është kërkuar të bëhen ndryshimet e statutit në legjislaturën e ardhshme. Tani është e njëjta situatë, unë kërkoj mirëkuptim, sepse ka arsye dhe nevojë për një zhvillim sa më të mirë të komunës me u bërë ndryshime në statut të komunës, ndërkaq është e drejtë e juaja me vlerësuar dhe me dhënë mendimin tuaj.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse miratohet ky draft, nuk bëhet i plotfuqishëm pa shqyrtimin e ligjshmërisë nga MAPL. MAPL mundet edhe të na e kthejë nëse vërejnë së nuk ka shkuar çdo gjë në rregull sa i përket procedurave.

**z. Adnan Reka,** E para, unë nuk pajtohem me atë që thotë Kryetari i Komunës që LVV ka pasur qëndrim tjetër më qëndrimin e sotëm. Vendimet i merr Kuvendi i Komunës e jo komisioni. E dyta, nuk pajtohem që po ndjekim shembuj të komunave që kanë shumë drejtori. Duhet ndjekur shembuj të komunave që kanë numër të vogël të drejtorive, administratë dhe që kryejnë shërbime moderne. Shtimi i drejtorive nuk kontribuon në të mirën e qytetarëve të komunës. Komuna mundet me funksionuar me pak drejtori dhe me qenë shumë efikase. Unë siç kam deklaruar edhe atëherë kur ishte sjellë Draft-Statuti i Komunës për votim, por me pas ishte tërhequr për arsye se nuk ishin votat e nevojshme siç duket, edhe tani jam kundër për të njëjtat arsye.

**z. Selim Reka,** Unë mendoj së propozimi jonë që dispozitat e nenit 27 të ndryshimeve statutare ka bazë juridike me hyrë në fuqi në legjislaturën vijuese, ndërkaq nëse mendoni së nuk kanë bazë, atëherë e çështjen e ndryshimeve të shtyjme për mbledhjen vijuese të KK dhe pyesim paraprakisht në ministri se a jemi në rregull me procedurat për ndryshim plotësimin e statutit të komunës.

**z. Ekrem Raka,** Të njëjta fjalë atëherë kur është shqyrtuar Statuti i Komunës, të njëjtat fjalë do t'i themi edhe tani. Nuk duhet marrë pikë referimi kryetar Hanin e Elezit që thuhet se i ka 8 drejtori. Pse të mos merret shembull ndonjë komunë me e zhvilluar dhe që ka më pak drejtori dhe që ka cilësi dhe funksionim të mirë. Zvicra fjala vjen me 7 milion banorë funksionon me 7 ministri.

**Kryetari i Komunës,** Nëse e marrim shembull komunën e Shtimes, Shtimja i ka më tepër së 8 drejtori. Me u ndryshuar dhe plotësuar Statuti i Komunës ka, nevojë, ka nevojë me u shtuar drejtoritë ka, për një funksionim më të mirë të komunës. Nuk pajtohem me mendimin e z. Ekrem Raka që thotë se Zvicra me 7 milion banorë funksionon me 7 ministri, sepse nuk mund t'i marrim shembull Zvicrën një shtet shumë të zhvilluar, me nivelin e komunave të Kosovës.

**z. Ekrem Kyçyku,** Ne subjekti politik i LVV është e vërtetë si e kemi pasur anëtarin tonë në komision të hartimit të statutit, mirëpo nuk janë hulumtuar aktet UA 01/2015 dhe Rregullorja e MAPL 01/2017 që i potencova më lartë për veprimet paraprake që duhet me i marrë komuna për me ndryshuar dhe plotësuar statutin e komunës në pajtim me këto dy akte.

**Kryetari i Komunës,** Shqetësimet të cilat i ngrite sot z. Ekrem Kyçyku, unë nuk i kam dëgjuar me parë. Mandatin që e merr një qeveri pavarësisht kush fiton në zgjedhje, ka me pa se ka qenë e arsyeshme dhe e nevojshme me u bërë ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të

Komunës, ndërkaq sa i përket çështjes që thuhet se po bëhen këto ndryshime për me punësuar bashkë- partiak, familjar, kjo nuk qëndron, sepse edhe ashtu kështu nuk i ka mbetur shumë mandat kësaj legjislature.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Në praktikat procedurale mundet me u hequr apo shtuar një nen, ndërkaq me hyrë në fuqi një nen pas 1 viti apo 2 viteve, për mendimin tim nuk është në rregull. Me u hequr neni 27 mundet, mirëpo me hyrë në fuqi me vonë ky nen, kjo nuk shkon. Akti shkon në ministri si tërësi dhe si tërësi hynë në fuqi, ndërkaq zotimi i Kryetarit të Komunës a i emëron drejtorët apo jo, ajo është çështje tjetër, zotimet tjera janë jashtë aktit. E votojmë kështu si është apo me ndryshimet që u propozuan, unë anën ligjore nuk e di, së nuk jam jurist.

**z. Kadri Krivenjeva,** Unë nuk i kuptoj kolegët e mi të LDK. Kur u propozua ndryshimi i Statutit të Komunës kah fundi i mandatit, thoni së nuk do të votojmë statutin se jemi në fund të mandatit, ndërkaq tani thonë së gati jemi në fillim të mandatit të legjislaturës vijuese. Sot është kjo legjislaturë, nesër mund të jetë dikush tjetër dhe statuti mbetet asaj legjislature që vjen në pushtet për funksionim të komunës në bazë të tij. Pavarësisht kush vjen në pushtet, këta janë njerëz të kësaj komune dhe nëse shtohet numri i drejtorive për funksion më të mirë dhe cilësi më të mira në shërbim të qytetarëve të komunës. atëherë çka ka gjë të keqe miratimi i këtyre ndryshimeve të statutit të komunës.

**z. Selim Reka,** Për dallim me herët tjera, sot në çështjen e Statutit të Komunës do të dalim me një kompromis, që neni 27 të filloj të zbatohet në legjislaturën vijuese të organeve të komunës.

**z. Adnan Reka,** Siç kam deklaruar edhe atëherë kur ishte sjellë Draft-Statuti i Komunës për votim, por me pas ishte tërhequr për arsye se nuk ishin votat e nevojshme siç duket, edhe tani jam kundër për të njëjtat arsye.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Para vitit 2008 ka qanë një Rregullore e UNMIK-ut që e ka përcaktuar numrin e drejtorive komunale, ndërkaq ligji i Vetëqeverisjes Lokale nuk e përcakton sesa duhet të jetë numri i drejtorive komunale, kështu që komunat kanë vendosur sipas nevojave të tyre formimin e drejtorive komunale.

**znj. Arlinda Rakoci-Raka,** MAPL mundet me na e kthyer Draft- Statutin për Ndryshim plotësimet e Statutit të Komunës, për shkak të procedurës, më konkretisht për shkak të procedurës së debatit publik me qytetarë.

**z. Bekim Koxha,** Nëse nuk është në rregull ana procedurale, atëherë është mirë këtë çështje me shtyrë për mbledhjen vijuese të Kuvendit të Komunës.

**z. Shemsedin Luzha,** Kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit që KK t'i epet një pauzë 5 minuta për konsultime të grupeve parlamentare të përfaqësuara në KK.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Atëherë a jeni për propozimin e Shemsedin Luzha për një pushim 5 minuta. Ky propozim u përkrah, ndërkaq pas kthimit nga pauza KK vazhdon më debatin për çështjen e Statutit të Komunës. Në vazhdim Kryesuesi Kërkoj nga z. Selim Reka të formuloj propozimin e subjektit politik të LDK-së.

**z. Selim Reka,** Subjekti politik i LDK-së është për ndryshim plotësimin e statutit të komunës, me përjashtim të zbatimit të nenit 27 që e përcakton ndarjen e dy drejtorive komunale-drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, me u ndarë Kultura si drejtori në veti dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, me u ndarë Zhvillimi Ekonomik si drejtori në veti. Këto dispozita të nenit 27 me u zbatuar në legjislaturën vijuese të organeve të komunës.

**z. Festim Neziraj**, Ne mendojmë se dispozitat e propozuara në statutin e komunës janë krejt në rregull. I pranojmë edhe propozimet e subjektit politik LDK që zbatimimi i nenit 27 të bëhet në legjislativë vijuese të organeve të komunës. Të provojmë të miratojmë në këtë formë, nëse e kthejnë MAPL e kthejnë, ne nuk kemi çka më bërë, nëse nuk e kthejnë, atëherë fillojmë me zbatimin e ndryshimeve të statutit të statutit të komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë a jeni të pajtimit që Statuti i Komunës të miratohet me ndryshimet të cilat u dhanë që neni 27 zbatimimi i tij të bëhet në legjislativë vijuese të KK. Me këto ndryshime, draftin e shtroj në votim për aprovim: Për votuan 20 anëtarë, Kundër votë ishin 6 anëtarë (5 anëtarët nga LVV dhe Ekrem Raka) votë Abstenim nuk ka. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

#### **APROVOJ**

**Statutin për Ndryshim Plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.3588/2008 të datës 25.09.2008. Lënda: 01Nr. 60/01-12895/20.**

**Dispozitat e nenit 27 e Statutit për Ndryshim Plotësimin e Statutit të Komunës do të zbatohen në legjislativë vijuese të organeve të komunës.**

**3. Harmonizimi i Rregullores 01Nr. 02-60/01-4863/20 e datës 28.02.2020 -për Taksat Komunale, në bazë të komenteve të MPB;**

**Kryesuesi i Kuvendit**, I lexoj nenet ku është kontestuar Rregullorja e taksave komunale si vijon: Të neni 10, është propozuar të hiqen paragrafët: 1.20. Lëshimi i pëlqimeve dhe dokumenteve tjera në fushën emergjencës - njëzet euro (20 €); 1.23 Kërkesa për fitim të shtetësisë- pesë euro (5 €); dhe 1.24 Kërkesa për tërheqjen e shtetësisë- pesëdhjetë euro (50 €). Nëse ka kush diçka e hap diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 21 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 4 anëtarë nga LVV përpos Adnan Reka i cili nuk ishte në sallë kur u votua kjo çështje. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e

#### **APROVOJ**

**Rregulloren 01Nr. 02-60/01-4863/20 e datës 28.02.2020 -për Taksat Komunale, në bazë të komenteve të MPB; duke hequr tarifën në dispozitat e nenit 10 si vijon:**

**1.20. Lëshimi i pëlqimeve dhe dokumenteve tjera në fushën emergjencës - njëzet euro (20 €);**

**1.23 Kërkesa për fitim të shtetësisë- pesë euro (5 €);**

**1.24. Kërkesa për tërheqjen e shtetësisë- pesëdhjetë euro (50 €).**

**Lënda: 01Nr. 02-60/01-4863/20.**

**4. Draft- Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut për vitet 2021-2023;**

**Kryesuesi i Kuvendit**, Për sqarime të nevojshme në këtë draft, fjalën e ka drejtori i DEFZH, Bahri Selimi.

**z. Bahri Selimi**, KABK është hartuar shumë i rëndësishëm për planifikim afatmesëm strategjik, është hartuar sipas kufijve fillestarë të përcaktuar me në bazë të Qarkores Buxhetore të MF Nr. 2021/01. Ky dokument i paraprinë procesit të buxhetit komunal 2021. Drejtori përmendi fazat e procesit buxhetor që kalon komuna deri në miratimin final të buxhetit.

Sipas KAB, Granti Qeveritar në vend ka shënuar rënie, kjo ka ndikuar edhe në nivel lokal, ndërkaq Granti specifik i Arsimit dhe Granti specifik i shëndetësisë kanë shënuar ngritje, ndërkaq të HVK janë në të njëjtin nivel. Të gjitha ngritjet dhe uljet e mjeteve buxhetore të grantet qeveritare, drejtori i përmendi edhe me shifra dhe totalin e përgjithshëm. Të lista e projekteve kapitale, janë marrë parasysh kërkesat në Debateve publike të organizuara me qytetarë të komunës. Një debat publik për KABK është mbajtur me 26 Qershor 2020. Projektet kapitale janë në shumë 2,339.574€ për vitin 2021 me një rritje të lehtë, një listë më e privilegjuar, sesa ajo e vitit paraprak. Ky është draft fillestar, ndërkaq Qarkorja e dytë buxhetore mund të pësoj ndryshime edhe për shkak të ligjit të pagave. Ka vend për ndryshime deri me miratimin e draftit final, Buxhetit të vitit 2021.

**Kryesuesi i Kuvendit**, I dëgjuat sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku**, Në Draftin e KABK të vitit 2020-2022 kemi bërë disa vërejtje, mirëpo të njëjtat nuk janë përmirësuar të gjitha dhe janë përsëritë në draftin e KABK 2021-2023. Z. Kyçyku i përmendi vërejtjet në pjesën e Përshkrimit të komunës dhe profili ekonomik faqe 5 dhe 6 të draftit kornizë, ndërkaq kërkoj nga qeveria të përmirësohen vërejtjet e lëshuara. Të projektet kapitale, Ndërtimi i infrastrukturës në zonave ekonomike, ka qenë prioritet në vitin në KABK 2020-2022, me 100.000€, ndërkaq është futur edhe tani në prioritet me vetëm 5.000€. Të sektori i bujqësisë, të projekti, të shtohet numri i hektarëve të tokave të punueshme, ne nuk kemi shtuar tokë të punueshme, por kemi humbur tokë të punueshme me ndërtimet e hidrocentraleve të cilat janë bërë përgjatë lumit lepenç. Në listë të prioritetëve, janë futur disa projekte kapitale të pa specifikuara me nga 5.000€, si projekti: “Ndërtimi dhe rregullimi i Parqeve publike” dhe projekti: “Ndërtimi dhe rivilatizimi i monumenteve kulturore –historike “ka pasur mjete buxhetore të planifikuara për realizimin e këtij projekti, ndërkaq tani në vitin 2021 janë paraparë vetëm 5.000€. Në Kaçanik mungojnë investimet shumë të rëndësishme si, terrenet sportive, çerdhet e fëmijëve si në qytet ashtu edhe në fshatra, ndërkaq me prioritet shihet së dominon përsëri asfalti në këtë draft kornizë.

**z. Adnan Reka**, Po t’i shohim pjesën e parë të KAB, të lë vërtetë një përshtypje të mirë dhe shpresëdhënëse, me kinse vizionin dhe strategjinë komunale duke u bazuar në pozitën gjeo-strategjike dhe resurset natyrore që ka komuna jonë. Por, kur marrim parasysh realitetin që përballemi si qytetarë të kësaj komune dhe dëshmitarë të këtij Kuvendi, del krejt ndryshe. Resurse të bollshme ujore, por pa ujë të mjaftueshëm për pije, me klimë të mrekullueshme, por me ajër që kundërmon nga lumenjtë tanë të bukur, por të degraduar deri në kanalizime të hapura të fekaleve, pyje shumë të bukura për turizëm, por fatkeqësisht të prera tej mase dhe të mbushura përplot me mbeturina gjithandej. Me pas, kemi një sallë. Kuvendi që për çdo vit ndajmë mjete financiare për inventar dhe mobilje, apo e kundërta, ka plane vetëm në letër si do të dukej një sallë dinjitoze e kuvendit, por që kurrë nuk realizohet. Atëherë pjesa e dytë e kësaj Kornize e tregon më së miri realitetin që i bie, në letër mund të shihni shumë gjëra, por në realitet nuk do të keni asgjë, përveç atyre që i keni parë tani e sa vite. (Është tjetër gjë, nëse hapësirat publike që duhet t’ju shërbejnë të gjithë qytetarëve ju i rezervoni për interesa private apo grupe). (Çfarë keni paraparë të investoni për fëmijë, (asgjë, me punë vullnetare, me 200/300 euro doni të arsyetoheni a) ju e dini që edhe përmes Rregullores për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve jeni të obliguar për një gjë të tillë. Neni 10, Buxheti për Fëmijë, 1.1 dhe 1.3 thotë mjaftueshëm çfarë duhet të bëni, vetë duhet ta lexoni dhe zbatoni në praktikë.

**z. Ekrem Raka**, Kur jemi të çështja e prioritetëve, të projekti, “Ndërtimi dhe Asfaltimi i rrugëve“, më intereson të di, A ka ende ndonjë rrugë të paasfaltuar në komunën tonë ?

**z. Selim Reka**, Të pika 14 e prioriteteve, “Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësve” janë paraparë 100.000€ për vitin 2021. Unë kërkoj që të gjenden mjete buxhetore apo donacione për hartimin e këtij projekti, për ujësjellësin në Kaçanik dhe në rrethinë të Kaçanikut, sepse uji është prioritet mbi të gjitha prioritetet. Të projekti, “Renovimi i objektit të shtëpisë së kulturës” Xheladin Kurtaj”, nuk e di nëse ka hyrë në këtë projekt edhe Renovimi i sallës së vogël ku u shpallë Kushtetuta e Kaçanikut, sepse ajo sallë është në gjendje të mjerueshme.

**znj. Nazife Krasniqi**, Të Projektet kapitale, ‘ Projekti ”Ndërtimi dhe rregullimi i Qarshisë së Vjetër të Qytetit”, janë paraparë në vitin 2021, 200.000€. Ku do të bëhet ky projekt, pasi që sipas informacioneve që kemi, aty do të bëhet tregu i gjelbër ? Kërkoj sqarime të nevojshme lidhur me lokacionin së ku do të realizohet ky projekt.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Lokacionin për Treg të gjelbër, e cakton Kuvendi i Komunës, kështu që pa ardhur kjo çështje këtu në KK, nuk mund të vendoset për lokacion për tregun e gjelbër.

**Kryetari i Komunës –Besim Ilazi**, Subjekti politik i LVV janë të njohur për ankesa. Termet teknike, gabimet në material mund të përmirësohen. Sa i përket çështjes së rrjetit të ujësjellësit, resurse natyrore të ujit ka, mirëpo kompania e ujësjellësit ka kaluar në nivel qendror në menaxhim. Të gjitha kompetencat për projekt etj. i ka marrë në menaxhim ministria. Ne nuk kemi mundur me realizuar projekt të ujësjellësit, sepse nuk kemi pasur projekt. Kompania regjionale e ujësjellësit “Bifurkacioni” e cila është dashur me bërë projektin, ka që 4 vite që i kemi bërë kërkesë, por kjo nuk është realizuar. Edhe pse ne nuk kemi pasur projekt të ujësjellësit nga kompania regjionale e ujësjellësit dhe për kundër kërkesave të vazhdueshme tona, kjo çështje nuk është realizuar. Çështjen e ujësjellësit e kemi ngritur disa herë këtë shqetësim. Pajtohem me juve, së duhet rritur shumat për ujësjellës, por këto janë kapacitetet tona. Vetëm projekti ujësjellësit kushton shumë ( e dha me shifër) dhe ne si komunë nuk kemi mundësi me mbuluar as projektin. Ne edhe me na sjellë projektin, kapacitetet e menaxherëve të komunës tonë mund të mos e kuptojnë sa duhet projektin, kështu që mos të na vjen puna me dalë qesharak, sikurse ishte me rastin e projektit i banimit kolektiv. Të çështja e kanalizimeve që kundërmojnë përmes lumit Nerodimja, ka pasur Peticion në Kuvendin e Kosovës, në vitin 2013, por nuk është marrë ndonjë hap në këtë drejtim për ndërtimin e impiantit për kundërmimet që vijnë nga Ferizaj, por edhe nga komuna jonë. Të çështja e kanalizimeve, vullneti ekziston, Impianti që na i kanë bërë francezët, realizimi kushton 22 milion euro. Vetëm projekti kushton 1 milion e dyqind mijë euro. Ne duhet me bërë trysni në nivel qendror për këtë projekt, sepse këto marrëveshje ratifikohen në Kuvendin e Kosovës. Kur është fjala të asfaltimi i rrugëve, nevoja ka për asfaltimin e rrugëve. Edhe ju-LVV kur e keni pasur pushtetin e keni pasur prioritet ndërtimin e rrugëve. Unë kujtoj së derisa sa do të ketë qytetarë, do të kenë nevojë për rrugë, sepse rriten nevojat për ndërtimin edhe të rrugëve të reja. Të Projekti, “Ndërtimi i Qarshisë së Vjetër e Qytetit” jemi duke e shqyrtuar këtë çështje se si më dhënë me qira atë pjesë për biznese të vogla, artizane e jo për treg të gjelbër qysh është thënë në rrjetet sociale dhe që po thuhet tani.

**z. Bekim Koxha**, Të projekti, “Ndërtimi dhe rregullimi i Qarshisë së Vjetër të Qytetit” ajo ku do të ndërtohet ky projekt, prona është në kontest gjyqësor sepse është ngritur padi për të. Ne kemi lokale aty që kemi paguar, është lokali i 16 nëntorit, ai e ka bërë padinë, A ka diçka rreth kësaj çështje, ku është problemi i atyre që kanë dhënë mjete lidhur me atë pronë kontestuese.

**Kryetari i Komunës**, Ai projekt është dashur me përfunduar në afatin e përcaktuar ashtu si e ka marrë lejen e ndërtimit, mirëpo i njëjti nuk e ka përfunduar deri në 2015-2016, Ne do të marrim veprime të nevojshme lidhur me këtë çështje. Me palën jemi kontestues, por

argumentet janë në anën tonë, sepse projekti nuk është përfunduar nga pala në kohën dinamike të përcaktuar. Deri në vitin 2022 besoj se do të na vjen vendimi i gjykatës.

**z. Ekrem Kyçyku**, Shënimet janë marrë nga KAB. Të Zonat industriale, 2020, ju vet e keni caktuar shumën 100.000€, ndërkaq tani keni propozuar 5.000€. E drejta jonë është më iu kritikuar se jemi opozitë dhe jemi duke folur me fakte e argumente për projekte të caktuara.

**Kryetari i Komunës**, Ne jemi duke i lënë prioritetet për të cilat nuk kemi ide, ndërkaq ato prioritetet po i kthejmë në projekte për të cilat ka ide konkrete.

**z. Adnan Reka**, Për çështjen e impianteve po arsyetoheni së nuk mundeni më bërë projekte, ndërkaq për ujësjellës duhet kërkuar alternativa për furnizimin e qytetarëve të komunës me ujë të pijes, sepse është nevojë me u realizuar ky projekt.

**Kryetari i Komunës**, U ndërlihdh me diskutimin e z. Adnan Reka, Sa ishit ju në pushtet të keni parasysh së edhe qeveria në pushtet nga LVV është marrë me projekte të asfaltit.

**z. Adnan Reka**, Për mikro- menaxhim të ujit, kamionët e mbeturinave shkojnë duke pikuar dhe kundërmon rruga. Këta kanë mundur me u hequr.

**z. Shemsedin Luzha**, Shqetësimi im është për infrastrukturën rrugore të projektit “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës që lidhë vendbanimet: Gërlicë-Kaçanik të Vjetër, Stagovë- Runjevë” , sepse mjetet e ndara buxhetore 15.000€ nuk janë të mjaftueshme për realizimin e këtij projekti. I përgëzoj organet relevante të komunës për marrjen e veprimeve të nevojshme në rehabilitimin e rrugëve të dëmtuara nga prerjet e asfaltit e të ngjashme.

**znj. Kaltrina Tafili**, Nuk di nëse të duken vajz Kryetar kërkesat e tona. Ne LVV kemi qenë në qeveri vetëm 50 ditë, ndërkaq ju që 20 vite nuk keni bërë me tepër punë sesa që ka bërë qeveria e LVV për 50 ditë.

**z. Bahri Selimi**, Për Projektin, Ndërtimin e Zonave Industriale, ministria na ka thënë që ne si komunë të vendosim për pronat, ndërkaq për investimet vendosin bizneset. Pronat në zonat industriale janë dhënë në shfrytëzim. Të kultura, është me vend vërejtja, mirëpo mua me është kërkuar nga DAK të fus një projekt të ri ‘Ndërtimin e Memorialit për viktimat civile të luftës’. Të propozimi i z. Selim Reka, Propozimi për projektin e ujësjellësit është me vend, janë 100.000€ të parapara në vitin 2021 kodi është në DUKMM, ndërkaq duhet rritur investimet për këtë projekt, sepse është nevojë me u realizuar ky projekt.

**z. Bekim Koxha**, Me intereson të di për projektin“ Projekte për zhvillimin e turizmit” çka është paraparë me u investuar ?

**z. Bahri Selimi**, Nuk ka ide konkrete për zonën e turizmit, janë paraparë ndërtimi i trotuareve në zonën turistike në f. Shtrazë.

**z. Bekim Koxha**, Të turizmi për një projekt të Malet të Sharrit kemi biseduar për asfaltim e rrugës dhe ndriçim e asaj rruge.

**z. Bahri Selimi**, Atij projekti që e potencon z. Koxha, mundemi me ia bashkangjitur një marrëveshje bashkëpunimi.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 6 anëtarë (5 anëtarët nga LVV dhe Ekrem Raka). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë

#### VENDIM

**Për Aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut për vitet 2021-2023; dhe e njëjta lëshohet në procedurën e Debatit publik me qytetarë / Lënda: 01Nr. 400/01-12855/20.**

5. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për N.K.P “Stacioni i Autobusëve” SH.A. - Kaçanik;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, kundër ishin 4 anëtarë nga LVV me përjashtim të Ekrem Kycyku i cili nuk ishte në sallë kur u votua kjo çështje. Abstenoj Ekrem Raka. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

#### VENDIM

**Për ndarjen e mjeteve financiare për N.K.P “Stacioni i Autobusëve” SH.A. – Kaçanik / Lënda: 01Nr. 60/01-12899/20.**

6. Propozim Vendim për rialokim dhe transfer të mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Atëherë, meqë nuk ka kush diçka tjetër, këtë Propozim vendim e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicë votash Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 4 anëtarët nga LVV dhe Ekrem Raka, ndërkaq Ekrem Kycyku nuk ishte në sallë kur u votua kjo çështje. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për rialokim dhe transfer të mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020 / Lënda: 01Nr. 400/01-12923/20.**

7. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën private të Mustafë Lama, për ndërtimin e rrugës në Kaçanik të Vjetër;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Bekim Koxha**, Kërkoj të di, ku janë arsyet e këmbimit të pronës komunale me pronën private të propozuara ?

**Kryetari i Komunës**, Kur është shtruar rruga Kaçanik i Vjetër – Begracë, Mustafë Lama iu ka marrë 2 ari në vitin 2004, lënda iu ka refuzuar dhe tani jemi në kontest gjyqësor më të. Tani me këtë këmbim, palës i japim pronë komunale 8 ari, ndërkaq i marrim diku 20 ari.

**z. Bekim Koxha**, Ne komunën tonë ka shumë konteste pronësore juridike dhe nëse ne fillojmë me i këmbyer pronat në fjalë, atëherë do të na paraqitën shumë raste.

**Kryetari i Komunës,** Pajtohem me mendimin e z. Bekim Koxha, sepse kërkesa për këmbim të pronave veç na janë adresuar.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Atëherë, meqë nuk ka kush diçka tjetër, këtë Propozim vendim e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicë votash Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 5 anëtarët nga LVV. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën private të Mustafë Lama, për ndërtimin e rrugës në Kaçanik të Vjetër / Lënda: 01Nr. 350/01-11436/20.**

**8. Raporti i Shtabit Emergjent për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Fillimisht iu njoftoj se e kam pasur një shkresë nga z. Kijani Sallahu-OJQ, i cili thekson së administratorët e f. nuk janë kompensuar me mjete buxhetore në vlerë 50€, por me 50 litra derivate. Ky gabim teknik duhet të përmirësohet. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Adnan Reka,** Unë së pari dua t'i falënderojë qytetarët e Komunës së Kaçanikut, për një vetëpërmbytje dhe disiplinë në menaxhimin e situatës pandemie me Corona Virus, duke pasur parasysh se jemi ndër komunat e Kosovës që kemi numrin më të vogël me të infektuar me COVID-19. Së dyti, është e pasaktë të thoni se Zyra e Kryeministrit apo Ministria e Shëndetësisë së asaj periudhe nuk e ka ndihmuar Komunën tonë. Në raportin tuaj thoni se më 16.03.2020 dhe 27.04.2020, ju keni kërkuar ndihmë nga Qeveria e asaj periudhe por nuk keni marrë përgjigje, e në anën tjetër në po të njëjtat data keni kërkuar ndihmë nga 'Jetimat e Ballkanit' dhe të njëjtit menjëherë i janë përgjigjur thirrjes. Mendoj se është tepër e ulët të raportoni të dhëna të pa sakta, sepse raporti i ministrisë për të gjitha komunat e Kosovës thotë, kështu: Më datë 02.03.2020, janë dërguar QKMF në Kaçanik: Respirator FFP2 100 copë, veshje mbrojtëse 54, 65 dhe 51 copë, mbrojtje për fytyrë, 80 copë, syza mbrojtëse 12, dorëza nitrile PATAL K-L 800, dorëza nitrile Patal K-M 800, Alkool 70% 50 copë, dezinfektues 4. Më datë 14.04.2020, Maska kirurgjikale 300 copë, 200 respirator FFP2, 300 veshje mbrojtëse, 500 veshje mbrojtëse, mbrojtje për fytyrë 100, syze mbrojtëse 100. E këto ndihma edhe kanë mund të jenë të paketa, por kur marrim parasysh situatën emergjente që ka qenë në tërë vendin dhe faktin se komuna jonë në atë kohë nuk kishte ende asnjë të prekur me COVID, del se komuna jonë është ndihmuar njësoj, e ndoshta edhe më mirë se komunat tjera. Së treti, unë mendoj se gjendja e mirë në komunën tonë nuk është si rezultat i menaxhimit të mirë, por është si rezultat i besueshmërisë së qytetarëve të Komunës tonë në njerëz kompetent siç është Profesor Lul Raka, të cilin nuk mjafton vetëm ta falënderoni, por, Lul Rakën, Visar Ramajlin dhe Jeton Nezirajn duhet së paku t' i ftoni në këtë Kuvend dhe t' i dekoroni si qytetar nderi të Komunës tonë, meqë ata po e mbrojnë jetë, punën dhe imazhin e Komunës tonë. Ky raport nxjerr në pah gjendjen e mjerueshme sociale që mbretëron në komunën tonë, e për këtë gjendje në të cilën gjendemi, nuk e di cilën qeveri do ta akuzoni.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Mungesa e pajisjeve ka qenë në QKMF, ku fajtor jemi edhe ne. Për vlerën e pajisjeve nuk janë raportuar nga DSHP dhe QKMF. Nuk e akuzoj qeverinë për keq

menaxhim, sepse menaxhimi i pandemisë Covid-19 ka qenë i mirë, ndërkaq të dhënat lidhur me pajisjet dërguar QKMF nuk janë raportuar.

**Kryetari i Komunës,** Ne kemi pasur pajisje për çështjen e menaxhimit të pandemisë Covid - 19, këto që po i thotë Adnani janë nga donacione OJQ dhe donatorë tjerë. Dy ekipe nga Komuna e Kaçanikut i kemi dërguar në zonat kufitare . Furnizimet nga ministria e shëndetësisë kanë qenë minimale, shkresat të cilat i kam dërguar ministrisë i kam bërë zyrtare. Premtimet e ministrit kanë qenë të mëdha, ndërkaq kur e kam marrë në Tel. nuk është lajmëruar. Unë kam me e ftuar drejtorin e QKMF me raportuar për furnizimet të cilat i kanë marrë nga ministria.

**z. Adnan Reka,** Unë nuk po foli për furnizimet e komunës nga OJQ, por për furnizimet nga ministria, të cilat të dhëna i kam marrë nga raporti zyrtar i publikuar , raport me nënshkrim dhe vulë, dhe këto të dhëna mund të verifikohen shumë lehtë. Raporti i Ministrisë së Shëndetësisë është i përgjithshëm për krejt komunat e Kosovës. Nëse ka mospërputhje të dhënave lidhur me furnizimet e ministrisë, atëherë dikush duhet të përgjigjet për këto.

**z. Selim Reka,** Nga raporti shihet së është bërë një punë e madhe e këtij shtabi. Unë e falënderoj shtabin emergjent dhe të gjithë kontribuuesit tjerë për kontributin e tyre në çfarëdo forme në luftimin e pandemisë Covid-19.

**znj. Hafize Sallahi,** Sa i përket Shtabit emergjent, është për t'u përgëzuar aktiviteti i zhvilluar në luftimin e Covid-19, i falënderoj edhe OJQ dhe çdo kush tjetër që ka kontribuar në luftimin e këtij virusi. Unë kryesues, kërkoj që për hera të tjera të respektohet rregullorja e punës së KK e jo të merr fjalën dikush ka dy tri herë për një çështje të caktuar.

**z. Ekrem Raka,** Ne anëtarët e KK jemi të zgjedhur e popullit, kështu që kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit me na lejuar debatin e minutave të përcaktuar si në rregulloren e punës së KK.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Unë mundohem me lejuar debatin për secilin anëtar të KK deri në fund, mirëpo duke debatuar për pikën që është çështje e debatit, ndërkaq edhe Rregullorja e punës së KK nuk lejon fyerje, kështu në këtë kuptim unë kam të drejtë me ia marrë fjalën secilit anëtar të KK.

**z. Bekim Koxha,** Të Pyetjet dhe Kërkesat, unë i kam vërejtjet e mia se nuk marrim përgjigjet e drejtuara organeve përkatëse.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Ky material nuk del në votim, atëherë konstatoj së Kuvendi i Komunës u,

#### NJOFTUA

**Me Aktivitetin e Shtabit Emergjent për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut, në bazë të Raportit të Shtabit Emergjent për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 104/02-12959/20.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:54. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët (26) sa ishin edhe në fillim të mbledhjes.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

*Makfire Malsiu*



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli

*Kemal Mërseli*

**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);**

**nga Mbledhja e IV –të (Katërt) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2020, mbajtur me 30 Qershor 2020;**

1. Kemal Mërseli..... \_\_\_\_\_,
2. Hamid Guri..... \_\_\_\_\_,
3. Ahmet Luma ..... \_\_\_\_\_,
4. Kadri Krivenjeva,..... \_\_\_\_\_,
5. Besim Vishi,..... \_\_\_\_\_,
6. Sali Malsiu..... \_\_\_\_\_,
7. Lirije Shurdhani..... \_\_\_\_\_,
8. Pranverë Loku- Zharku..... \_\_\_\_\_,
9. Lirije Luta..... \_\_\_\_\_,
10. Vlora Dalloshi..... \_\_\_\_\_,
11. Nexhat Loku ..... \_\_\_\_\_,
12. Agim Mani..... \_\_\_\_\_,
13. Adnan Reka..... \_\_\_\_\_,
14. Ekrem Kyçyku..... \_\_\_\_\_,
15. Fatijona Kyçyku..... \_\_\_\_\_,
16. Kaltrina Tafili ..... \_\_\_\_\_,
17. Selim Reka..... \_\_\_\_\_,
18. Besnik Salihu,..... \_\_\_\_\_,
19. Nazife Krasniqi..... \_\_\_\_\_,
20. Arlinda Rakoci-Raka..... \_\_\_\_\_,
21. Shemsedin Luzha..... \_\_\_\_\_,
22. Albana Troni..... \_\_\_\_\_,
23. Afërdita Shehi,..... \_\_\_\_\_,
24. Hajredin Luta..... \_\_\_\_\_,
25. Hafize Sallahi ..... \_\_\_\_\_,
26. Bekim Koxha..... \_\_\_\_\_,
27. Ekrem Raka,..... \_\_\_\_\_,



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipality of Kaçanik

## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 17.07.2020

**Për:** Anëtarët e Kuvendit/ z. Adnan Reka,  
znj. Lirije Shurdhani  
znj. Kaltrina Tafili

### Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe të jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruar para Kuvendit të Komunës, më datë 30.06.2020, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

#### **z. Adnan Reka,**

Kërkojmë që të rregullohet ndriçimi publik njëherë e mirë, nga shtëpia e kulturës "Xheladin Kurtaj" deri tek xhamia e dëshmorëve, sepse siç kemi thënë edhe më parë, mënyra siç Ju po e neglizhoni në vazhdimësi, me vetëdije apo pa vetëdije, po i kontribuoni rritjes së aktiviteteve të ndaluara që ndodhin në këtë pjesë të qytetit.

- *Kompania e kontraktuar për projektin "Mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik" në vazhdimësi intervenon. në sanimin e defekteve që krijohen në rrjetin ekzistues të ndriçimit publik. Poashtu edhe në rrjetin e ndriçimit publik përgjatë lumit Nerodime kemi intervenuar në sanimin e defekteve të paraqitura si pasojë e dëmtimit të llampave ndriçuese (që zakonisht janë si pasojë e faktorit njeri). Së fundmi më dt.15.07. 2020 është intervenuar prap në rregullimin dhe rifunksionalizimin e këtij rrjeti.*

**znj. Lirije Shurdhani,** Unë kam një kërkesë për drejtorin e shërbimeve Publike; Rruga "Muhamet Zeneli" në f. Bob ka pasur disa probleme, ndërkaq keni thënë që është në provë për tu rregulluar për arsye të nxehtësisë së gypave gjatë reshjeve të vullshme. A keni marrë ndonjë vendim për rregullimin e asaj rruge.


- *Ju informoj se këtë vit, në kuadër të projektit "Rregullimi i infrastrukturës në fshatin Bob" do të vazhdohet me fazën përfundimtare të rregullimit të rrugicës lidhëse nga rruga "Muhamet Zeneli" me rrugën "Vëllezërit Çaka", te shkolla fillore "Idriz Seferi "Bob".*

**znj. Kaltrina Tafili,** Unë e kam një Kërkesë për Drejtorinë e Infrastrukturës lidhur me rrugët të cilat janë filluar me u ndërtuar dhe janë lënë në gjysmë. Disa rrugë janë dëmtuar, si rrugët: në 'Lagjia e Re' dhe rruga në lagjen: " Dushkaja". Rruga në " Lagjia e Re " ka kohë që është dëmtuar, ndërkaq nuk është marrë ndonjë veprim për rehabilitimin e saj. Në rrugën në lagjen "Dushkaja" pothuajse në çdo hap ka prerje të asfaltit, ndërkaq nuk është marrë asnjë hap për rehabilitimin e saj. Më intereson kur do të rehabilitohen këto rrugë, ndërkaq ka edhe rrugë të tjera të cilat janë dëmtuar me prerje asfalti dhe krijimin e gropave, të cilat rrugë kanë nevojë për rehabilitim.

- *Kompania për mirëmbajtjen verore të rrugëve lokale është duke intervenuar, sipas planifikimeve të drejtorisë, në rehabilitimin e dëmtimeve të rrugëve me shtresë asfalti në Dushkajë. Në këtë fazë, do të intervenojmë edhe në Lagje të Re dhe në të gjitha lokacionet e evidentuara për sanimin e dëmtimeve në rrugët publike të komunës sonë sipas dinamikës së paraparë për vitin 2020.*

Ju falnderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,

  
Ramadush Osmani  
Drejtor i DSHPE-s

